



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së pestë të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më
27.6.2023, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Gëzim Sveçla (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Rashit Gashi (LVV), Petrit Reçica (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Faton Zeka (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Violeta Salihu (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Radie Hoxhaj, (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Fehmi Kupina (i pavarur), Pëllumb Bajqinovci (LDK), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajšhori (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Sami Salihu (LDK), Amir Simnica (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Fatmir Dervishi, (PDK), Granit Geci (PDK), Liridon Selmani, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Gresa Lahu (PDK), Berna Saraçi (PDK), Bahri Gashi (AAK), Kushtrim Mushica (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), Endrit Zabërgja (NISMA) dhe Agim Kuleta (LB).

Munguan: Trieria Kasumi-Berisha (LVV), Berat Lahu (LVV), Ermal Osmani (LVV) dhe Feim Osmani (LVV).

Të pranishëm ishin edhe: Përparim Rama, kryetar i Komunës, Alban Zogaj, nënkryetar i Komunës, Donjeta Sahatçiu, nënkryetare e Komunës, Donat Lushaku, drejtor i Drejtorisë së Kadastrit, Mimoza Sylejmani, drejtore e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Ilirik Musliu, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Adelina Sahiti, drejtore e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Granit Rugova, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Besianë Musmurati, drejtore e Drejtorisë së Arsimit, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Doruntinë Maloku, drejtore e Drejtorisë së Pronës, Plator Gërdovci, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Krenar Xhaferi, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, Florian Dushi, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, Arben Kçira, përfaqësues nga Zyra ligjore, Betim Avdullahu, përfaqësues nga Zyra për komunitete dhe kthim, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe përfaqësues të OJQ-ve.

Faqe nga 7

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fehmi Kupina, kryesues i Kuvendit.

Ai fillimisht i njoftoi të pranishmit se asamblistja Berna Saraçi, ish anëtare e LVV-së, nga dt. 21.06.2023, zyrtarisht është pjesë e Grupit parlamentar të subjektit politik të PDK-së.

Kryesuesi hapi diskutimin rreth pikave të rendit të ditës.

Valbona Makolli, drejtore, propozoi që në rend të ditës të futen pikat:

Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit, 01-400/01-69255/23, të dt. 3.4.2023, për bartjen e mjeteve nga viti 2022 në vitin 2023;

Propozimvendimi për subvencionimin e fondacionit "Robin Haxhi Krasniqi", për organizimin e ndeshjes së boksit profesionist ndërkombëtar.

Lulzim Fushtica, drejtor, propozoi që në rend të ditës të futet pika:

Propozimvendimi për subvencionimin e personave fizikë dhe juridikë, të cilët marrin në përkujdesje dhe mbajtje një qen apo më shumë.

Jeta Rafuna theksoi se duke pasur parasysh se z. Kupina ka dhënë dorëheqje nga GP i LDK-së, ne si GP kërkojmë që të futet në rend të ditës pika: Propozimvendimi për shkarkimin e kryesuesit të Kuvendit të Komunës z. Fehmi Kupina.

Amir Simnica, propozoi që në rend të ditës të futen pikat:

Propozimvendimi për anulimin e Vendimit numër 01-0601117700/23, të datës 8.6.2023, për shkarkimin e anëtarëve në komisionet e ndërmarrjeve publike të Komunës së Prishtinës;

Propozimvendimi për anulimin e Vendimit 01-0601117701/23, të datës 8.6.2023, për caktimin e anëtarëve në komisionet e aksionarëve të ndërmarrjeve publike të Komunës së Prishtinës.

Gëzim Sveçla propozoi që kjo seancë të mbyllet dhe të mos mbahen seanca të tjera deri në publikimin e Vendimeve të seancës së jashtëzakonshme, të dt. 8.6.2023.

Gëzim Mehmeti ngriti shqetësim lidhur me mospublikimin e vendimeve, duke thënë se mospublikimi i qëllimshëm i vendimeve të Kuvendit komunal nga Kryetari i Komunës, mohon të drejtën e publikut për të qenë të informuar, e që për më tepër ky veprim rrezikon legjitimitetin e institucioneve tona dhe shkakton dyshime dhe mosbesim. Ndërhyrjet joligjore në legjislacion nuk duhet të tolerohen, ne duhet të qëndrojmë së bashku në mbrojtje të ligjshmërisë dhe drejtësisë për të siguruar se vendimet e tona janë të bazuara në ligj dhe duhet të respektohen.

Bahri Gashi u shpreh se është tejet i pakuptimtë mospublikimi i vendimeve të Kuvendit të Komunës nga ana juaj, kryetar, andaj duke pasur parasysh rrethanat, mendoj se kjo seancë nuk ka kuptim të mbahet dhe të vazhdohet më tutje, përderisa të bëhet publikimi i vendimeve.

Në momentin kur Përparim Rama, kryetar, e mori fjalën, fjalimi i tij u pengua nga sjelljet dhe reagimet e opozitës. Duke pasur parasysh rrethanat e krijuara, Fehmi Kupina, kryesues i Kuvendit, seancën e shpalli të mbyllur.

Vazhdimin e mbledhjes e braktisën GP i LVV-së dhe i AAK-së.

Faqe2nga7

Përparim Rama, kryetar, tha se përderisa ekziston kuorumi, ka kushte dhe seanca mund të vazhdojë, përderisa ka kushte seanca nuk mund të mbyllet dhe për këtë çështje kërkoi një interpretim ligjor nga Zyra ligjore.

Arben Kçira, përfaqësues nga Zyra ligjore, tha se sipas Statutit dhe Rregullores së punës të Kuvendit, seanca nuk llogaritet e mbyllur përderisa një grup parlamentar ka bërë braktisjen nga seanca dhe asamblisti më i moshuar mund ta udhëheq seancën.

Ajet Brajshori, kryesues, fillimisht konstatoi se prezent në sallë janë 28 anëtarë të Kuvendit, andaj dhe ka kushte për vazhdimin e mbledhjes.

Kryesuesi i hodhi në votim propozimet e dhëna si në vijim:

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për dhe 2 abstenim, u miratua propozimi, që Propozimvendimi për subvencionimin e personave fizikë dhe juridikë, të cilët marrin në përkujdesje dhe mbajtje një qen apo më shumë, futet në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se më 28 vota për, u miratua propozimi që Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit 01-400/0169255/23, i dt. 3.4.2023, bartja e mjeteve nga viti 2022 në vitin 2023, futet në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për dhe 1 abstenim, u miratua propozimi që Propozimvendimi për shkarkimin e kryesuesit të Kuvendit komunal, z. Fehmi Kupina, futet në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se më 28 vota për, u miratua propozimi që Propozimvendimi për subvencionimin e fondacionit "Robin Haxhi Krasniqi", për organizimin e ndeshjes së boksit profesional ndërkombëtar, futet në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua propozimi që, Propozimvendimi për anulimin e Vendimit numër 01-0601117700/23, të datës 8.6.2023, për shkarkimin e anëtarëve në komisionet e ndërmarrjeve publike të Komunës së Prishtinës, futet në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua propozimi që, Propozimvendimi për anulimin e Vendimit 01-0601117701/23, të datës 08.06.2023, për caktimin e anëtarëve në komisionet e aksionarëve të ndërmarrjeve publike të Komunës së Prishtinës, futet në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se më 27 vota kundër, nuk u miratua propozimi i z. Sveçla për mbylljen e seancës së pestë të Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për, u miratua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt të Kuvendit të Kryeqytetit;
2. Propozimvendimi për shkarkimin e kryesuesit të Kuvendit komunal, z. Fehmi Kupina;
3. Propozimvendimi për anulimin e Vendimit, nr. 01-0601117700/23, të datës 8.6.2023, për shkarkimin e anëtarëve në komisionet e ndërmarrjeve publike të Komunës së Prishtinës;
4. Propozimvendimi për anulimin e Vendimit nr. 01-0601117701/23, të datës 8.6.2023, për caktimin e anëtarëve në komisionet e aksionarëve të ndërmarrjeve publike të Komunës së Prishtinës;
5. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit, nr. 01-4000169255/23, të datës 3.4.2023, për bartjen e mjeteve nga viti 2022 në vitin 2023;
6. Korniza afatmesme buxhetore 2024-2026 (KAB);
7. Propozimi i Projektstatutit të Poliklinikës Stomatologjike;
8. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Nazmi (Ruzhdi) Fetahut dhe Magbule (Shahin) Sadrisë;
9. Propozimplani lokal i veprimit për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Prishtinës 2023-2026;
10. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Institucionit parashkollor në fshatin Llukar në Prishtinë;
11. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Institucionit parashkollor në fshatin Busi në Prishtinë;
12. Propozimvendimi për subvencionimin e fondacionit "Robin Haxhi Krasniqi" për organizimin e ndeshjes së boksit profesional ndërkombëtar;
13. Propozimvendimi për subvencionimin e personave fizikë dhe juridikë, të cilët marrin në përkujdesje dhe mbajtje një qen apo më shumë;
14. Raporti vjetor i punës për vitin 2022, i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
15. Pyetje dhe përgjigje;
16. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt të Kuvendit të Kryeqytetit.

Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së katërt të Kuvendit.

Pika e dytë

Propozimvendimi për shkarkimin e kryesuesit të Kuvendit komunal, z. Fehmi Kupina.

Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për, u miratua Vendimi për shkarkimin e kryesuesit të Kuvendit komunal, z. Fehmi Kupina.

Pika e tretë

Propozimvendimi për anulimin e Vendimit nr. 01-0601117700/23, të datës 8.6.2023, për shkarkimin e anëtarëve në komisionet e ndërmarrjeve publike të Komunës së Prishtinës.

Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për, u miratua Vendimi për anulimin e Vendimit nr. 01060111770023, të datës 8.6.2023, për shkarkimin e anëtarëve në komisionet e ndërmarrjeve publike të Komunës së Prishtinës.

Pika e katërt

Propozimvendimi për anulimin e Vendimit 01-0601117701/23, të datës 8.6.2023, për caktimin e anëtarëve në komisionet e aksionarëve të ndërmarrjeve publike të Komunës së Prishtinës.

Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për, u miratua Vendimi për anulimin e Vendimit nr. 01-0601117701/23, të datës 8.6.2023, për caktimin e anëtarëve në komisionet e aksionarëve të ndërmarrjeve publike të Komunës së Prishtinës.

Pika e pestë

Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit, nr. 01-4000169255/23, të datës 3.4.2023, për bartjen e mjeteve nga viti 2022 në vitin 2023.

Kryesuesi konstatoi se më 28 vota për, u miratua vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit, nr. 01-4000169255/23, të datës 3.4.2023, për bartjen e mjeteve nga viti 2022 në vitin 2023.

Pika e gjashtë

Korniza afatmesme buxhetore 2024-2026 (KAB).

Për këtë pikë të pranishmit në pika të shkurta i informoi Valbona Makolli, drejtore.

Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për, u miratua Korniza afatmesme buxhetore 2024-2026 (KAB).

Pika e shtatë

Propozimi i Projektstatutit të Poliklinikës Stomatologjike.

Lidhur me Projektstatutin e Poliklinikës Stomatologjike, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Izet Sadiku, drejtor.

Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për, u miratua Statuti i Poliklinikës Stomatologjike.

Pika e tetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Nazmi (Ruzhdi) Fetahut dhe Magbule (Shahin) Sadrisë.

Për këtë pikë të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Doruntinë Maloku, drejtore.

Kryesuesi konstatoi se më 28 vota për, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Nazmi (Ruzhdi) Fetahut dhe Magbule (Shahin) Sadrisë.

Pika e nëntë

Propozimplani lokal i veprimit për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Prishtinës 2023-2026.

Lidhur me Propozimplanin lokal të veprimit për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Prishtinës 2023-2026, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Betim Abdullahu, përfaqësues i Zyrës për komunitete dhe kthim.

Kryesuesi konstatoi se më 28 vota për, u miratua Plani lokal i veprimit për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Prishtinës 2023-2026.

Pika e dhjetë

Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Institucionit parashkollor në fshatin Llukar në Prishtinë.

Lidhur me Propozimvendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Institucionit parashkollor në fshatin Llukar në Prishtinë, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Mimoza Sylejmani, drejtore.

Kryesuesi konstatoi se më 28 vota për, u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Institucionit parashkollor në fshatin Llukar në Prishtinë.

Pika e njëmbëdhjetë

Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Institucionit parashkollor në fshatin Busi në Prishtinë.

Kryesuesi konstatoi se më 28 vota për, u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Institucionit parashkollor në fshatin Busi në Prishtinë.

Pika e dymbëdhjetë

Propozimvendimi për subvencionimin e fondacionit "Robin Haxhi Krasniqi" për organizimin e ndeshjes së boksit profesional ndërkombëtar.

Për këtë pikë të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Valbona Makolli, drejtore.

Kryesuesi konstatoi se më 28 vota për, u miratua Vendimi për subvencionimin e fondacionit "Robin Haxhi Krasniqi" për organizimin e ndeshjes së boksit profesional ndërkombëtar.

Pika e trembëdhjetë

Propozimvendimi për subvencionimin e personave fizikë dhe juridikë, të cilët marrin në përkujdesje dhe mbajtje një qen apo më shumë.

Lidhur me këtë propozimvendim, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Lulëzim Fushtica, drejtor.

Sami Boroci tha se sa i përket trajtimit të kësaj pike, rekomandoj që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për në njërin nga seancat e radhës, pasi që rreth kësaj çështjeje ka disa paqartësi.

Endrit Zabërgja tha se trajtimin e qenve endacakë e konsideroj njërin prej problemeve me prioritet të kryeqytetit, prandaj pyes se a ekziston mekanizëm që siguron se këto mjete nuk do të bien në dorë të keqpërdorueseve dhe që nuk do të keqtrajtohen qentë pastaj. Andaj shtrohet pyetja se cili është ai mekanizëm që garanton se ato para që paguhen për atë qen do të shkojnë te ai në këtë rast.

Lidhur me sugjerimet e ngritura nga parafolësit, sqarime shtesë dha Përparim Rama, kryetar.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua **Vendimi për subvencionimin e personave fizikë dhe juridikë të cilët marrin në përkujdesje dhe mbajtje një qen apo më shumë.**

Pika e katërbëdhjetë

Raporti vjetor i punës për vitin 2022, i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Për Raportin vjetor të punës për vitin 2022, të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Lulëzim Fushtica, drejtor.

Kryesuesi konstatoi se më 28 vota për, u miratua **Raporti vjetor i punës për vitin 2022, i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.**

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i mbledhjes
Pëllumb Bajcinovci



Faqe7nga7